




BASHKIA FUSHË ARRËZ



BUXHETI PËR VITIN 2026



MESAZHI BUXHETIT

Të nderuar Këshilltarë !

Të nderuar qytetarë të Bashkisë Fushë – Arrëz !

Të nderuar përfaqësues të Shoqërisë Civile !

Kam kënaqësinë të paraqes sot para Jush draft Buxhetin e Bashkisë Fushë – Arrëz për vitin 2026. Buxheti i kësaj periudhe financiare është ndërtuar mbi realizimin e treguesve buxhetorë në vite duke ndjekur hap pas hapi një axhendë të mirpërcaktuar të të gjithë aktiviteteve të parashikuara për realizimin e këtij procesi. Si një dokument thelbësor, ai rregullon veprimtarinë ekonomike të Bashkisë jo vetëm në raport me institucionet e tjera por, mbi të gjitha me vetë komunitetin. Hartimi i këtij dokumenti mbështet në katër parime kryesore dhe konkretisht:

- Së pari: Transparenca dhe gjithpërfshirja
- Së dyti: Disiplina fiskale
- Së treti: Shpërndarja e burimeve dhe përdorimi eficient i tyre
- Së katërti: Përgjegjësia dhe përgjegjshmëria në menaxhimin e burimeve financiare

Puna për përgatitjen e tij ka përshkuar disa etapa duke filluar me a) ngritjen e grupit të punës për ndërtimin e analizave ekonomiko – financiare, b) evidentimin e problemeve dhe përcaktimin e rrugëve për zgjidhjen e tyre brenda kuadrit ekonomik vendor, c) rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit në proces, d) anketimet qytetare për evidentimin e nevojave të komunitetit dhe e) rivlerësimit dhe rimobilizimit të burimeve tona financiare. Ky buxhet merr në konsideratë të gjitha mundësitë reale për përmbushjen e objektivave të Zhvillimit të Bashkisë sonë nëpërmjet:

- përmirësimit të strukturës së shërbimeve publike
- përmirësimit të strukturës së mbështetëse të arsimit parashkollorë dhe të mesëm
- përmirësimit të strukturës së shërbimeve të rrugëve rurale
- përmirësimit të strukturës së administrimit pyjorë



Buxheti Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026



- përmirësimit të strukturës së mbrojtjes nga zjarri
- përmirësimit të menaxhimit të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë
- ruajtjen e vazhdimësisë së kryerjes së investimeve të planifikuara
- përmirësimin e të ardhurave të veta të Bashkisë nëpërmjet planifikimit analitik të tyre
- mbajtjes nën kontroll të shpenzimeve për çdo njësi shpenzuese
- rritjes së kontrollit mbi territorin

Politikat tona financiare synojnë rritjen e potencialit tonë ekonomik jo vetëm nga burimet tona por ato trajtojnë me vëmendje maksimale forcimin e bashkëpunimit me donatorët strategjikë. Politikat tona në fushën e investimeve kapitale për vitin 2026 synojnë:

- kryerjen e investimeve në funksion të rritjes ekonomike.
- rritjes së cilësisë së shërbimeve publike dhe zgjerimit të tyre.

realizimi të cilave do të mundësohet nëpërmjet:

1 – financimit të investimeve kapitale

2 – përmirësimin e shërbimit të pastrimit, të gjelbërimit dhe ndriçimit në territorin e Bashkisë tonë.

3 – paraqitjen e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës së qytetit dhe aplikimin tek Ministritë e linjës, FZHR dhe donatorë të ndryshëm të vendas dhe të huaj.



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

Adresa: Fushe-Arrez, Prefektura Shkoder, Tel: 027123131, Email: info@bashkiafushearrez.gov.al

Nr. 3722/1, Prot.

Fushë Arrëz me 27/11/2025

RELACION

Lënda: Mbi Buxhetin e Bashkisë Fushë – Arrëz për vitin 2026 dhe planifikimi për 2026-2028

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Fushë – Arrëz

Hartimi i buxhetit vjetor reflekton punën disamujore të stafit të Bashkisë sonë e mbi të gjitha ai pasqyron gjerësisht kërkesat bazë të komunitetit të evidentuara në dëgjuesat publike, kontaktet direkte dhe në anketimet e zhvilluara nga ana jonë. Nëpërmjet këtij programi ne synojmë mbështetjen dhe realizimin e objektivave tona të Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë, realizimi të cilave është prioriteti ynë kryesor. Do të veçonim disa faktorë kryesorë të buxhetit të kësaj periudhe, e konkretisht:

a) Buxheti ynë është transparent dhe i balancuar – Në mbulimin e të gjitha aktiviteteve të njësive shpenzuese ai ruan raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve duke u mbështetur në një analizë të hollësishme të trendit të tyre në vitet e fundit dhe planifikimit të kujdesshëm për vitin pasardhës duke planifikuar mbulimin e shpenzimeve operative të Bashkisë dhe financimin e prioriteteve pa cënuar nivelin e shërbimeve publike të ofruara për komunitetin. Mbulimi i shpenzimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë në buxhet është një tjetër tregues i balancimit të nevojave me mundësitë duke synuar përmirësimin e strukturës së shpenzimeve. I mbështetur në një kalendar aktiviteteve të detajuar ai pasqyron dhe merr në konsideratë të gjitha prioritetet e komunitetit tonë të evidentuara edhe në takime të ndryshme me komunitetin. Ruajtja e trendit të investimeve të veta dhe me donatorë i japin atij atributin e një plani financiar të mundshëm për tu realizuar.

b) Ai është i besueshëm – Përgjatë hartimit të buxhetit është marrë në konsideratë ndikimi i politikave ligjore të ndërmarrë në aspektin e të ardhurave të veta të Bashkisë. Planifikimi i të ardhurave zë për zë merr në konsideratë jo vetëm realizimin e tyre në vite por mbi të gjitha ai mbështetet në një analizë të hollësishme për çdo kategori biznesesh dhe kategorive të tjera taksapaguese. Mjafton të përmendim faktin e ruajtjes së dinamikës



së të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore si dhe ruajtjen e strukturës së bizneseve taksapaguese.

c) Efektiv – Efektiviteti i buxhetit tonë lidhet me nivelin e realizimit të treguesve për të ardhurat dhe shpenzimet. Ky faktor del në pah gjatë përshkrimit analitik të treguesve për të gjitha taksat dhe tarifat vendore por edhe për shpenzimet sipas njësive shpenzuese dhe për çdo sektor. Ruajtja e nivelit të shpenzimeve për banor si dhe kënaqshmëria e komunitetit janë një tregues i qartë i efektivitetit të tij. Ai mbështet në vizionin tonë të Zhvillimit të qytetit dhe në tërësi të Bashkisë dhe synon financimin e projekteve konkrete të evidentuara në këtë vizion.

d) është gjithpërfshirës – për realizimin e këtij procesi janë angazhuar jo vetëm stafi i Bashkisë, i Njësive administrative por edhe drejtuesit e Institucioneve të vartësisë, pa anashkaluar kontributin e gjithë komunitetit tonë të dhënë gjatë dëgjësive publike.

Të dhëna të përgjithëshme

Bashkia Fushë Arrëz shtrihet përgjatë ish rrugës kombëtare Shkodër – Kukës – Prishtinë dhe gjendet në pjesën verilindore të Shqipërisë. Aktualisht Fushë - Arrëzi përbëhet nga kater Njesi administrative dhe Bashkia qender dhe numëron 11 498 banorë, ose 3 791 familje, ku rreth 994 familje (ose 24%) trajtohen me ndihmë ekonomike dhe paaftësi në Bashki. Rreth 35% e popullsisë jeton në qytet ndërkohë që 65% e tyre jetojnë në zonat rurale. Në kontekstin gjeografik, Bashkia Fushë – Arrëz shtrihet në një zonë malore me një sipërfaqe prej 540 km², ku 927 ha e zënë toka bujqësore. Qyteti i Fushë Arrëzit njihet si një qendër e vogël industriale ku ka mbizotëruar për vite me radhë industria e përpunimit të drurit dhe fabrika e pasurimit të bakrit. Mbyllja e Industrisë së përpunimit të drurit, u shoqërua me një gjendje të vështirë ekonomike të qytetit dhe me rritje të papunësisë e cila mbetet një prej problemeve kryesore të Bashkisë. Zhvillimi i sektorit privat lidhet me ekzistencën e një numri të kufizuar njësish tregtare (kryesisht biznesi vogël) i cili shkon në rreth 143 biznese ku 85% e të cilëve vlerësohen biznesi i vogël dhe 15% vlerësohen biznesi i madh. Për nga numri i popullsisë sot shërbejnë 1 biznes i vogël / 97 banorë dhe 1 biznes i madh / 548 banorë. Burimi kryesor i punësimit deri tani është fabrika e përpunimit të bakrit së bashku me disa fabrika të prodhimit të ujit janë motorët e Zhvillimit perspektiv të qytetit. Një fushë e rëndësishme e zhvillimi është edhe sektori i turizmit malor, përcaktuar këto edhe në vizionin tonë të Zhvillimit të Bashkisë.



Pak fjalë mbi buxhetin e Bashkisë

Politikat e investimeve të Bashkisë do të synojnë mbështetjen financiare të kërkesave të komunitetit në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe ofrimit të mundësive për zgjerimin e biznesit në Bashki. Pavarësisht potencialit ekonomik të Bashkisë, investimet këtë vit do të shoqërohen me politika specifike në favor të grupeve të ndryshme. Megjithë politikat stimuluese të aplikuara ende buxheti i Bashkisë ndihet “i pasigurtë”, kjo për shkak të numrit të subjekteve debitorë. Analiza më poshtë do të synojë planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të Bashkisë për vitin 2026 nxitur nga përllogaritjet analitike të treguesve dhe përmirësimit të menaxhimit të fondeve në dispozicion.

Baza ligjore

Veprimtaria për hartimin dhe zbatimin e buxhetit mbështetet në:

- ⇒ nenin 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
- ⇒ ligjin 8379 datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të RSH”
- ⇒ ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”
- ⇒ ligjin nr. 7776, datë 22.12.1993 “Për buxhetin lokal” të ndryshuar
- ⇒ udhëzimin nr. 2 dt. 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”
- ⇒ ligjin 9632 dt. 30.10.2006 “Për Taksat Vendore”
- ⇒ ligjin 9920 dt. 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”
- ⇒ ligjin 9932 dt. 09.06.2008 “Për disa ndryshime në ligjin 9632”
- ⇒ ligji 10 117 dt. 23.04.2009 “Për disa ndryshime në ligjin 9632”
- ⇒ 142/2015 “Për disa ndryshime në ligjin 9632”
- ⇒ VKM nr. 328 date 31.05.2023 l ndryshuar me VKM nr. 503, date 1.8.2024, “Për nivelin e pagave të Njësive të vetëqeverisje vendore”
- ⇒ ligjin nr. 9869 datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”
- ⇒ ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit (QKR)”
- ⇒ ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSh”
- ⇒
- ⇒ udhëzimin nr 21 dt.18.09.2007 “Për zbatimin e V.K.M nr 369 dt. 13.06.2007 “Për fondin e vecantë në insitucionet buxhetore”
- ⇒ ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”



- ⇒ ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- ⇒ Ligji 115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”
- ⇒ Ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”
- ⇒ Shkresa nr. 14448 “Për njoftimin e transfertës së pakushtëzuar dhe sektoriale për vitin 2025”.

Analiza dhe Planifikimi i treguesve të Buxhetit për vitin 2026

Buxheti i vitit 2026 përfshin të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e njësisë së qeverisjes vendore fondin rezervë, Kontigjencën në masën 1% të vlerës së Buxhetit dhe një fond Emergjence deri në masën 4 000 mijë lekë, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen ose janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Përdorimi i tij bëhet me vendim të Këshillit të Bashkisës së qeverisjes vendore. Fondi i Emergjencës përdoret sipas përcaktimit në vendimet e Këshillit të Bashkisë për të përballuar efektet e situatave të emergjencave të krijuara gjatë vitit.

I. Të Ardhurat

Të ardhurat e Bashkisë për vitet 2026 do të vijnë nga Taksat dhe Tarifatat Vendore të cilat janë programuar në përputhje me Paketën Fiskale të hartuar dhe të miratuar në Këshillin e Bashkisë si dhe transfertat e pakushtëzuar, transfertat e kushtëzuar dhe ajo specifike. Është shumë rëndësishme të përmendim se gjatë gjithë materialit tonë ne do të referohemi të dhënave mbi nivelin e realizimit të të ardhurave për periudhën Janar – Nëntor 2025 dhe planit vjetor të të ardhurave. Duke kaluar një për një të gjitha të ardhurat buxheti i Bashkisë sonë mbështetet në planifikimin e të ardhurave të veta dhe transfertave nga qeveria qendrore.



Buxheti Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026



Tabela 1 Të hyrat 2026.

lekë

Emertimi	Vlera
Te ardhurat e veta	28,555,000
Transferta e pakushtezuar	151,281,180
Transferta e specifike	139,314,766
Te trashguara me destinacion	4,759,195
Te trashguara pa destinacion	37,424,805
TOTALI:	361,334,946


Grafiku 1 Raporti ndërmjet transfertave për vitin 2026.

Në grafik paraqitet raporti ndërmjet Transfertës specifike dhe Transfertës së pakushtëzuar.



Grafiku 2 Pesha specifike e të ardhurave.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur pesha specifike e të ardhurave të planifikuara.



A. Transferta e pakushtëzuar

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar janë të ardhura pa kthim mbrapsht të cilat i transferohen buxhetit vendor nga buxheti nacional. Kjo transfertë përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për përdorimin e të cilave Këshilli Bashkiak ka autoritet të plotë vendimmarrës. Në këtë aspekt, të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2026 janë në masën 151,281,180 lekë, duhet theksuar fakti se në vitin 2025 transferta e pakushtëzuar është 137,190,608 lekë. Vetëm nga krahasimi i treguesve të mësipërm rezulton se transferta e pakushtëzuar në vitin 2025 është e vogël se ajo e vitit 2026, ndonëse kjo e fundit do të mbarte mbi vete koston normes se inflacionit qe eshte mesatarisht 3% çdo vit me tendence rrijte, e cila na tregon një vit të vështire financiare. Nëse shohim nivelin e të ardhurave nga ky burim në vite rezulton se Bashkia jonë ka përfituar konkretisht:

Tabela 2 Niveli i transfertës së pakushtëzuar në vite.

Nr	Emërtimi	2025	2026
1	Transferta e Pakushtëzuar lekë	137,190,608	151,281,180
2	Transf. e Pakusht.	11,677.78	12,877.19




Buxheti Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026



Leke/banorë¹

Sa shihet nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar nivelin më të lartë të tyre kanë këtë vit financiar, pavarësisht faktit që transferimi funksioneve specifike të reja kërkon mbështetje financiare nga ana jonë.

Grafiku 3 Transferta e pakushtëzuar për 2025-2026.



Shpërndarja e transfertës për banorë

Për nga niveli i shpërndarjes së të ardhurave nga ky burim për banorë, rezulton se niveli më i lartë është në vitin 2026, ku dhe niveli i transfertës së pakushtëzuar në raport me vitet e mëparshme është edhe më i lartë. Bazuar në numrin e popullsisë në Bashkinë tonë, duke

¹ Përlogaritjet janë bërë për 11 498 banorë




Buxheti Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026



marrë në raport këta tregues të transfertës së pakushtëzuar rezulton se shpërndarja e tyre për banor në vite është sipas grafikut më poshtë:

Grafiku 4 Transferta e pakushtëzuar/banorë



II.SHPENZIMET

Aktiviteti ekonomik i Bashkisë është i lidhur ngushtësisht me shpenzimet për paga dhe ato operative, pa të cilat Bashkia nuk do të mund të përmbushë asnjë prej detyrimeve të veta. Në vitin 2026, kemi një rritje të shpenzimeve për faktin se nga lidhshmëria është parë e arsyeshme ruajtja e strukturës organike të mëparshme dhe shtimin e saj për të përmbushur disa shërbime shtesë.

Shpenzimet operative dhe kapitale të Bashkisë nga transfertat e pakushtëzuar dhe ajo specifike.

Viti	2024	Raport në %	2025	Raport në %	2026	Raport në %
Buxheti Pavarur	444 310		4481 263		361 335	
Shpenzimet operative	402 443	91	465 893	86	361 335	100
Investimet	41 867	9	63 317	14		0




Buxheti Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026



Shënim: Në tabelë nuk janë përfshirë fondet e trashëguara.

Nga tabela më sipër rezulton se në raport me buxhetin, shpenzimet e Bashkisë për paga dhe të tjera operative nuk ruajnë pothuajse të njëjtën strukturë me një vit mëparë, në vitin 2024 këto raporte janë në limitet 91% me 9% me burimet e financimit të shpenzimeve kapitale, në vitin 2025 janë 86% me 14% ndërsa në vitin 2026 kemi një ndryshim në favor të shpenzimeve operative siq duket edhe në tabelën e mësipërme. Në këtë panoramë të shpenzimeve rezulton se buxheti ynë rezulton i qëndrueshëm dhe i prirur drejt shpenzimeve në rritjen e cilsisë së jetës në komunitet dhe zbatimi i tij nënkupton aktivitet ekonomik të garantuar të Bashkisë dhe institucioneve në varësi dhe ruajtjen e rritmit të investimeve nga njëri vit në tjetrin në trend rritje. Pavarësisht kësaj, zgjerimi i buxhetit është shoqëruar me rritjen e të gjithë zërave brenda strukturës buxhetore ku shpenzimet për pagat e të tjera operative janë rritur nga viti i mëparshëm. Në këtë rritje ndikon rritja pagave sipas VKM përkatëse për pagat e aparatit administrativ dhe funksioneve specifike.

Grafiku 5 Struktura e buxhetit për periudhën 2025 – 2026



Grafiku më sipër jep pikërisht, strukturën buxhetore të Bashkisë për periudhën 2025 – 2026, ku evidentohen shpenzimet operative të Bashkisë dhe shpenzimet kapitale për investime, nga ku rezulton se buxheti i Bashkisë për vitin 2026 ka ndryshim të dukshëm në alokimin e fondeve për vitin, kjo për shkak se buxheti i vitit 2025 ka të përfshirë dhe të trashëguarat nga viti i mëparshëm.



Buxheti Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026



Po tu referohemi shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik, vemë re që pjesën më të madhe në të gjitha vitet e zënë shpenzimet për paga e sigurime shoqërore, kjo mbasi shumica e shërbimeve që ofrohen në komunitet nuk janë me sipërmarrje, por janë sektorë që i mbulon Bashkia me strukturat e saj.


Tabela 4 Struktura e shpenzimeve ne Bashki (Transferta e pakushtëzuar. Specifike dhe të ardhurat e veta)

Emertimi	2025	2026
Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	263,531,601	257,142,441
Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	43,614,341	43,932,287
Mallra dhe sherbime te tjera	64,421,441	53,470,218
Subvencionet	0	0
Transferime korrente te brendeshme	340,000	340,000
Transferimet korrente jashte	0	0
Transferta per buxhetet familiare dhe individet	796,480	450,000
Rezervat	10,140,000	6,000,000
Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0
Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0
Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	18,999,324	0
Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	29,422,731	0
Shpenzime transferimet kapitale	0	0
Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0
Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0
Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	0	0
Shpenzime transferimet kapitale	0	0
Shuma:	431,265,918	361,334,946


Sa më sipër në tabelë rezulton se brenda strukturës buxhetore, shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore zënë një pjesë të madhe të buxhetit, çka shpjegohet me faktin e ofrimit të shërbimeve nëpërmjet ndërmarrjes së vet Bashkisë si dhe pagesat që do të bëhën nga transfera specifike për funksionet e reja.

Sipas peshës specifike që zë çdo aktivitet brenda strukturës së buxhetit tonë rezulton si më poshtë:

Grafiku 6 Struktura sipas artikujve (Transferta e pakushtëzuar, transferta sektoriale, transferta e kushtezuar, te trasheguara dhe te ardhura)



Grafiku 7 Struktura sipas programeve dhe aktiviteteve (Transferta e pakushtëzuar dhe specifike)



**SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIVE**

Shpërndarja e buxhetit për vitin 2026, sipas programeve paraqitet si më poshtë:

Programet	Viti 2026
AA155 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	120,491,381
AB155 - Siguria publike	40,953,904
AC155 - Zhvillimi Ekonomik dhe Rural	40,809,337
AD155 - Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale	74,520,093
AE155 - Punet Publike	82,560,231
AF155 - Fondi Rezervë dhe Kontigjencë	2,000,000
Totali:	361,334,946

a.Për programin AA155 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi.

Që sistemohen në programin sipas llogarive ekonomike në tabelën mëposhtme:

lekë

PROGRAMI	Viti	Llogaria ekonomike					Shuma
		600	601	602	604	606	
AA 155	2026	76,583,502	12,996,879	30,121,000	340,000	450,000	120,491,381
Totali:		76,583,502	12,996,879	30,121,000	340,000	450,000	120,491,381

Shenim: -Në artikullin 604 është tarifa për tranjime 220 000 mijë/lekë, 100 mijë/lekë kuotë anëtaresie për Këshillin e Qarkut si dhe 1% tatim i thjeshtuar fitimi 20 mijë/lekë.

b.Për programin AB155 – Siguria Publike.

Që sistemohen në programin sipas llogarive ekonomike në tabelën mëposhtme:

lekë

PROGRAMI	Viti	Llogaria ekonomike					Shuma
		600	601	602	609		
AB 155	2026	27,799,983	4,450,680	4,703,241	4,000,000		40,953,904
Totali:		27,799,983	4,450,680	4,703,241	4,000,000		40,953,904



Buxheti Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026



Shënim: Në artikullin 609 vlera prej 4 000 000 lekë, janë parashikuar fonde për emergjenca civile.

c.Për programin AC155 – Zhvillimi ekonomik dhe rural.

Që sistemohen në programin sipas llogarive ekonomike në tabelën mëposhtme:

lekë

PROGRAMI	Viti	Llogaria ekonomike					Shuma
		600	601	602			
AC 155	2026	30,426,273	5,405,087	4,977,977			40,809,337
Totali:		30,426,273	5,405,087	4,977,977			40,809,337

d.Për programin AD155 – Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale.

Që sistemohen në programin sipas llogarive ekonomike në tabelën mëposhtme:

lekë

PROGRAMI	Viti	Llogaria ekonomike					Shuma
		600	601	602			
AD 155	2026	64,928,590	11,616,641	6,015,000			82,560,231
Totali:		64,928,590	11,616,641	6,015,000			82,560,231

e.Për programin AE155 – Punët publike.

Që sistemohen në programin sipas llogarive ekonomike në tabelën mëposhtme:

lekë

PROGRAMI	Viti	Llogaria ekonomike					Shuma
		600	601	602			
AE 155	2026	57,404,093	9,463,000	7,653,000			74,520,093
Totali:		57,404,093	9,463,000	7,653,000			74,520,093

e.Për programin AF155 – Fondi Rezervë dhe i Kontigjencës.

Që sistemohen në programin sipas llogarive ekonomike në tabelën mëposhtme:

lekë

PROGRAMI	Viti	Llogaria ekonomike					Shuma
----------	------	--------------------	--	--	--	--	-------



Buxheti Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026



					609		
AF 155	2026						
Fondi Rezervë					1,000,000		1,000,000
Kotigjenca					1,000,000		1,000,000
Totali:					2,000,000		2,000,000

Numri maksimal i punonjësve është **315** dhe totali i shpenzimeve për paga sipas programeve dhe funksioneve në shumën **257,142,441** lekë për vitin 2026

Për të krijuar një panoramë më të përmblodhur dhe të çartë për shpërndarjen e mësipërme, ju lutemi referohuni tabelave të mëposhteme:

Transferta e pakushtëzuar e vitit dhe shtesa e nivelit të pagave.

Kodi	Programet	Artikull								
		600	601	602	603	604	606	609	231	Shuma
AA 155	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	57,006,996	11,535,879	16,249,000		320,000	450,000			85,561,875
AB 155	Siguria publike	7,903,120	1,319,260	130,000						9,352,380
AC 155	Zhvillimi Ekonomik dhe Rural	2,669,760	445,849							3,115,609
AD 155	Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale	13,090,704	2,254,612	3,256,000						18,601,316
AE 155	Punet Publike	24,322,000	5,428,000	2,900,000						32,650,000
AF 155	Fondi Rezervë dhe Kontigjencë							2,000,000		2,000,000
Totali :										151,281,180

Transferta sektoriale e vitit.

Kodi	Programet	Artikull								
		600	601	602	603	604	606	609	231	Shuma
AA 155	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi									
AB 155	Siguria publike	17,896,863	3,131,420	4,573,241				4,000,000		29,601,524



Buxheti Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026

AC 155	Zhvillimi Ekonomik dhe Rural	19,919,625	4,959,238	4,977,977						29,856,840
AD 155	Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale	51,837,886	9,362,029							61,199,915
AE 155	Punet Publike	12,147,487	3,142,000	3,367,000						18,656,487
AF 155	Fondi Rezervë dhe Kontigjencë									
Totali :										139,314,766

Transferta pakushtëzuar e trashëguar nga viti i kaluar.

Kodi	Programet	Artikull								Shuma
		600	601	602	603	604	606	609	231	
AA 155	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	5,187,506								5,187,506
AB 155	Siguria publike									
AC 155	Zhvillimi Ekonomik dhe Rural	5,077,693								5,077,693
AD 155	Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale									
AE 155	Punet Publike	14,537,606								14,537,606
AF 155	Fondi Rezervë dhe Kontigjencë									
Totali :										24,802,805

Transferta specifike e trashëguar nga viti i kaluar.

Kodi	Programet	Artikull								Shuma
		600	601	602	603	604	606	609	231	
AA 155	Planifikimi, Menaxhimi,									



Buxheti Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026

	<i>Administrimi</i>									
AB 155	<i>Siguria publike</i>	2,000,000								2,000,000
AC 155	<i>Zhvillimi Ekonomik dhe Rural</i>	2,759,195								2,759,195
AD 155	<i>Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale</i>									
AE 155	<i>Punet Publike</i>									
AF 155	<i>Fondi Rezervë dhe Kontigjencë</i>									
Totali :										4,759,195

Të ardhurat e vitit.

<i>Kodi</i>	<i>Programet</i>	<i>Artikull</i>								
		<i>600</i>	<i>601</i>	<i>602</i>	<i>603</i>	<i>604</i>	<i>606</i>	<i>609</i>	<i>231</i>	<i>Shuma</i>
AA 155	<i>Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi</i>	3,464,000	1,461,000			20,000				18,817,000
AB 155	<i>Siguria publike</i>									
AC 155	<i>Zhvillimi Ekonomik dhe Rural</i>									
AD 155	<i>Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale</i>			2,759,000						2,759,000
AE 155	<i>Punet Publike</i>	4,700,000	893,000	1,386,000						6,979,000
AF 155	<i>Fondi Rezervë dhe Kontigjencë</i>									
Totali :										28,555,000

Të ardhurat e trashëguara nga viti i kaluar.

<i>Kodi</i>	<i>Programet</i>	<i>Artikull</i>								
		<i>600</i>	<i>601</i>	<i>602</i>	<i>603</i>	<i>604</i>	<i>606</i>	<i>609</i>	<i>231</i>	<i>Shuma</i>

**Buxheti Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026**

AA 155	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	10,925,000								10,925,000
AB 155	Siguria publike									
AC 155	Zhvillimi Ekonomik dhe Rural									
AD 155	Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale									
AE 155	Punet Publike	1,697,000								1,697,000
AF 155	Fondi Rezervë dhe Kontigjencë									
Totali :										12,622,000

Të ardhurat mbi limitin.

Kodi	Programet	Artikull								
		600	601	602	603	604	606	609	231	Shuma
AA 155	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi									
AB 155	Siguria publike									
AC 155	Zhvillimi Ekonomik dhe Rural									
AD 155	Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale									
AE 155	Punet Publike									
AF 155	Fondi Rezervë dhe Kontigjencë									
Totali :										



Të nderuar Këshilltarë!

Projekti i paraqitur nga ana jonë merr në konsideratë kërkesat e komunitetit si dhe prioritetet e përcaktuara tashmë në Bashki. Njëkohësisht ai vjen si një Plan Veprimi konkret në duart e të gjithëve ne, në funksion të përmbushjes së objektivave të përcaktuar në vizionin tonë të Zhvillimit Ekonomik të Fushë Arrëzit. Natyrisht ai nuk mundet të adresojë të gjitha kërkesat dhe nevojat e komunitetit tone, por gjithsesi ky projekt sjell pranë njëri – tjetrit të gjithë aktorët e lidhur me të dhe adreson zgjidhjen e objektivave tanë strategjikë. Parë në këtë këndvështrim, ai mbetet ambicioz dhe puna për realizimin e tij do të kërkojë angazhimin e të gjithëve ne së bashku. Mbi të gjitha ky projekt financon mbi bazë të rivlerësimit të të gjithë burimeve financiare të Bashkië, ndërkohë që financimi i investimeve kapitale të parashikuara nuk do të lerë jashtë vëmendjes sonë aplikimin për thithjen e fondeve nga burime të ndryshme si jashtë dhe Brenda vendit për investime. Diskutimet tuaja do të pasurojnë akoma dhe më tej këtë projekt i cili nuk është projekti i administratës së Bashkisë por i të gjithëve ne, së bashku.

PËRGATITI MATERIALIN :

DREJTORI I FINANCËS

Dritan LIKA

K R Y E T A R I

HiL CURRI

PËRGJEGJËSE E ZYRËS JURIDIKE

Redona HASANI